



2-004-4350 7 04.07.2013

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



R R E G U L L O R E

PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË JUNIKUT

Maj 2013

Në pajtim me dispozitat e nenit 12, paragrafi 2, pika c të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), dispozitat e neneve 15 dhe 34 të Ligjit nr. 04/L – 60, për mbeturina, dhe dispozitat e nenit 22, paragrafi 1, pika 3 të Statutit të Komunës së Junikut, Kuvendi i Komunës së Junikut, në mbledhjen e mbajtur më 28.05.2013, miratoi këtë:

RR E G U L L O R E

PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË JUNIKUT

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Më këtë rregullore përcaktohen orari, sistemimi dhe kushtet për mënyrën e mbledhjes së mbeturinave, mënyrën e shpërndarjes dhe vendosjes së kontejnerëve, mirëmbajtjen e vendeve ku grumbullohen mbeturinat dhe mënyrën e transportimit të tyre.

Neni 2

Përkufizimet

Termat e përdorura në këtë rregullore nënkuptojnë:

1. "**Grumbullimi i mbeturinave**" quhet procesi i pranimit të mbeturinave në vende të caktuara.
2. "**Konsumatori**" quhet një njësi komerciale, industriale a institucionale, ose një person që mund të përdorë shërbimet e kontejnerëve dhe ku shërbimi i mbledhjes së mbeturinave sigurohet nga kontraktuesi.
3. "**Largimi publik i mbeturinave**" quhet procesi i dorëzimit, mbledhjes, transportimit dhe grumbullimit të mbeturinave.
4. "**Mbeturina**" janë lëndët ose objektet që dalin nga veprimtaria njerëzore ose ciklet natyrore të destinuara për braktisje.
5. "**Operatori**" personi, i cili në përputhje me dispozitat e këtij ligji menaxhon, kontrollon, është përgjegjës për objektet dhe pajisjet e mbeturinave dhe është i autorizuar të marrë vendime në lidhje me funksionet ekonomike ose teknike të pajisjeve dhe objekteve;

6. **"Person"** nënkuptohet çdo person fizik ose juridik i cili është i involvuar në mënyrë direkt apo indirekte, në proceset për administrimin e mbeturinave.
7. **"Menaxhim i mbeturinave"** nënkupton , mbledhjen , grumbullimin, transportimin trajtimin e mbeturinave dhe deponimin e tyre përfshirë monitorimin dhe kujdesin edhe pas kryerjes së këtyre aktiviteteve.
8. **"Mbeturina komunale"** janë mbeturina nga amvisëritë dhe aktivitetet tjera të ngjashme të cilat në përbërjen e tyre nuk janë të klasifikuara si mbeturina speciale, industriale dhe te rrezikshme .
9. **"Mbeturina komerciale"** nënkupton mbeturinat që krijohen për shkak të aktiviteteve të bizneseve për qëllime të funksionimit të tregut dhe zejeve .
10. **"Mbeturina inerte"** janë mbeturina që nuk pësojnë ndryshime të rrezikshme kimike fizike apo Biologjike.
11. **"Prodhuës i mbeturinave"** konsiderohen personat juridik dhe fizik të cilët për shkak të aktiviteteve të tyre prodhojnë mbeturina.
12. **" Deponi e mbeturinave"** Vend i caktuar dhe rregulluar për mbeturina, ku do të vendosen mbeturinat nën apo mbi sipërfaqe të tokës.

II.PERGJEGJËSITË DHE DETYRAT E KOMUNËS

Neni 3

Përgjegjësit dhe detyrat e komunës të parapara me këtë rregullore janë në përputhje me ligjin për mbeturinat, dhe atë:

1. Hartimi i planit lokal të veprimit për menaxhimin e mbeturinave,
2. Hartimi i raportit vjetor për menaxhimin e mbeturinave,
3. Rregullimi i përgjegjësisë dhe detyrave për kryerjen e shërbimeve,
4. Informimi i publikut,
5. Zbatimi i procedurës së prokurimit për përzgjedhjen e operatorit për mbeturina,
6. Caktimi i tarifave për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave
7. Mbikëqyrja e menaxhimit të mbeturinave,
8. Dhënia e informatave dhe rekomandimeve.
9. Sipas Ligjit Nr.04/L-060, neni 10, paragrafi 4 për mbeturina, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor administron me mbeturinat e rrezikshme në bashkëpunim me komunat përkatëse.

Neni 4

Kjo rregullore trajton mbeturinat komunale dhe komerciale, mbledhjen dhe grumbullimin e tyre dhe transportimin nga vendi i prodhimit të mbeturinave deri në deponin e mbeturinave.

Neni 5

Të gjithë krijuesit e mbeturinave janë të obliguar të regjistrohen në listat e shërbimit të konsumatorëve për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave.

Neni 6

Administrimi i mbeturinave bëhet nga Operatori kontraktues për menaxhim mbeturinash në Komunën e Junikut.

Neni 7

Personat juridik dhe fizik që konsiderohen prodhues të mbeturinave kanë këto Obligime

1. Bizneset

- 1.1 Bizneset të cilat operojnë në komunën e Junikut kanë për obligim që individualisht të posedojnë kontejnerët ku i hedhin mbeturinat.
- 1.2 Kontejnerët apo shportat duhet të jenë të vendosura brenda lokacioneve, në pjesën e përparme ose të pasme të lokalit.
- 1.3 Vendosja e kontejnerëve duhet të bëhet nën mbikëqyrjen e organit kompetent komunal, Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Inspektion, që mos të ndikoj negativisht në dukjen e qytetit dhe të bëhen pengesë për kalimtarë,

2. Ekonomitë familjare

- 2.1 Janë të obliguara që të kenë kontejnerët individual ose të përbashkët varësisht nga natyra e organizimit të tyre.
- 2.2 Ndërtesat kolektive ku ka shumë njësi banuese (banesa) mundë të kenë një kontejner të përbashkët.
- 2.3 Vendosja e kontejnerëve bëhet:
 - a). Për ekonomit familjare me banim në shtëpi individuale kontejneri vendoset brenda oborrit të shtëpisë ose para derës së hyrjes në oborr,
 - b). Për ekonomit familjare në banesa kolektive vendosja e kontejnerit bëhet para objektit në një hapësirë ku nuk pengohen banuesit dhe qytetarët.

3. Institucionet

1. Të gjitha institucionet publike dhe private janë të obliguara të pajisen me kontejner,
2. Kontejnerët duhet të jenë të vendosur në vendet ku është e mundur qasja sa më e lehtë për shërbimin e transportit të mbeturinave, si dhe të mos jenë pengesë për qytetarët.

Neni 8

Obligimet e Ndërmarrjes kontraktuese

1. Hartimin e planit vjetor për menaxhimin e mbeturinave,
2. Azhurnimin e planit vjetor dhe rishqyrtimin e tij në periudha të përcaktuara me ligjin mbi mbeturinat,
3. Zhvillimin e kapaciteteve për futjen në sistem për grumbullimin mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave deri në deponin e mbeturinave për të gjithë territorin e komunës,
4. Lidhjen e kontratave individuale me prodhuesit e mbeturinave,
5. Grumbullimin dhe mbledhjen e mbeturinave sipas marrëveshjes nën kushtet kontraktuese,
6. Transportimin e mbeturinave deri në deponin e mbeturinave ,

7. Mbledhjen e mbeturinave në bazë të orarit të përcaktuar në marrëveshje të nënshkruar me Komunën e mbikëqyrë Drejtoria për Shërbime Publike dhe Inspeksion,

Neni 9

Të drejtat e Operatorit

1. Ndërmarrja ka të drejtë të bëjë trajtimin e mbeturinave që nënkupton ndarjen e mbeturinave në lloje, më qëllim të pakësimit të karakteristikave të dëmshme,
2. Të bëjë ndërmjetësimin, të organizoj shitjen, mbledhjen përpunimin dhe deponimin e mbeturinave,
3. Të vendosë në vende të caktuara kontejnerët për ndarjen e mbeturinave, shpenzimet për vendosjen dhe administrimin e këtyre kontejnerëve e bartë vetë ndërmarrja.

Neni 10

Përzgjedhja e Operatorit

1. Operatorit ekonomik që do të merret me grumbullimin dhe përpunimin e mbeturinave, zgjidhet me procedurë ligjore sipas LPP-se të Kosovës,
2. Personat që menaxhojnë mbeturinat licenca iu lëshohet me dispozitat e nenit 55 të ligjit për mbeturina.

Neni 11

Ndërprerja e Operimit për mbledhjen e mbeturinave

1. Ndërprerja e aktiviteteve të operatorit për mbledhjen e mbeturinave bëhet vetëm atëherë kur operatori nuk iu përmbahet kushteve të përcaktuara me kontratë.
2. Para se të ndërpritet kontrata, Komuna e njofton me shkrim operatorin lidhur me shkeljen e bërë, jep vërejtjet, propozon masat dhe cakton afatin kohor për zbatim të kushteve të kontratës.
3. Me rastin e ndërprerjes së kontratës, operatorit i ndalohet aktiviteti për mbledhjen e mbeturinave të prodhuara nga Komuna, institucionet e tjera publike Komunale dhe hapësirat publike.

Neni 12

1. Inspektimin e aktiviteteve për administrimin e mbeturinave e bënë Inspektori Komunal për Mbrojtje të Mjedisit. Inspektori komunal autorizimet i ushtron në përputhje me ligjet në fuqi.

Neni 13

MASAT NDËSHKIMORE

1. Masave ndëshkimore ju nënshtrohen të gjithë prodhuesit e mbeturinave dhe ndërmarrja që bënë administrimin e mbeturinave,
2. Të gjithë prodhuesit e mbeturinave të cilët bëjnë hedhjen e tyre në vende që s'janë të destinuara për këtë qëllim do të dënohen me gjobë,
3. Me gjobë nga 10 deri 50 euro ndëshkohen kategoritë e ekonomive familjare,
4. Me gjobë nga 50 deri 200 ndëshkohen kategoritë komerciale,
5. Me gjobë nga 50 deri 300 ndëshkohen kategoritë institucionale,
6. Me gjobë prej 300 deri 800 ndëshkohet kompania ne rastet e hedhjes se mbeturinave në vendet që s'janë të destinuara si deponi për mbeturina.

Neni 14

Dispozitat Përfundimtare

Për çështjet që s'janë të rregulluara me dispozitat e kësaj rregullore Komunale, vlejné dispozitat e Ligjit për Mbeturina dhe Udhëzimet Administrative që trajtojnë këtë fushë, si dhe Rregullorja për Mirëmbajtjen e Pastërtisë në Territorin e Komunës së Junikut të datës, 28.02.2011.

Neni 15

Kjo rregullore hynë në fuqi tetë ditë pas miratimit të saj në Kuvendin Komunal.

Më datë: 28.06.2013

Në Junik

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Sinan Gacaferi

